



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**



V E N D I M

Nr. 14 datë 26.02.2021

RISHQYRTIM I V E N D I M I T NR 37 DATE 25.06.2020.

“Për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 0.1029 ha për Agropylltari me afat 9 vjeçar në ngastrën nr.4 në ekonomine pyjore Drin Gjader kire.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 25 pika 1 e ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.1029 ha për Agropylltari në ngastrën nr.4 në ekonomine pyjore Drin Gjader kire me afat 9 vjeçar.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti, sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**ZV/KRYETAR
ERVIS SHIMAJ**

Sekretari i Këshillit Bashkiak
ARDIAN ÇELEPIJA

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim 2

Zbardhur me datë 04.03.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL DHE TURIZMIT
Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

INFORMACION

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Lidhur me projekt vendimin nr. 5 datë 03.03.2020 për dhënjen në përdorim të sipërfaqes prej 0.1029 ha për agropylltari ju informojmë:

Meqenëse sipërfaqja e kërkuar ndodhet në ekonominë pyjore Drin Gjadër kirë ngastra nr. 11, ku në këtë ekonomi pyjore kalon lumi Drin, Bashkia Vau Dejës me shkresën nr 6551 prot. datë 09.11.2020, i është drejtuar Agjensisë së Burimeve Natyrore pranë kryeministrit Tiranë, ku është kërkuar sqarim mbi hartën e basenit ujqor Drin Bunë, gjurmën e brigjeve me qëllim mundësimin e dhenjes në përdorim të kesaj sipërfaqeje, e cila ndodhet mbas argjinaturës. Jemi informuar nga Agjencia e Burimeve Natyrore me shkresën nr. 1103/2 date 17.11.2020, e cila ju është dërguar për dijeni edhe në Prefekturën shkodër dhe ndër të tjera sqaron se:

Në lumejtë e përrrenjtë, shtretërit e të cileve janë të mbrojtur me argjinaturë dhe/ose strukturë gjatësore e tërthorë mbrojtëse, kanë seksione të sistemuara, zona dhe gjerësia e bregut është hapsira toksore me ose pa ujë që krijohet ndërmjet argjinaturave, strukturave mbrojtëse, seksioneve të sistemuara dhe kufirit natyror të lumit me tokën.

Për rastin e sipërfaqes prej **0.1029 ha** të kërkuar për tu marrë në përdorim, kjo sipërfaqe ndodhet mbrapa argjinaturës ku ujqrat e lumit Drin nuk hyjnë apo dalin, gjë që nuk përbën pengesë për dhenjen e saj me qira, pasi lumi është i sistemuar me argjinaturë të rregullt në të dy anët e tij.

Gjithashtu dhënia me qira e sipërfaqes prej **0.1029 ha** nuk bie ndesh me ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar nenet 66,67.

Sa më sipër kërkojmë rishqyrtimin dhe miratimin e projekt vendimit për ti hapur rrugë procedurave të mëtejshme.

Faleminderit për mirëkuptimin

PER DREJTORINË E ZHVILLIMIT RURAL DHE TURIZMIT

Specialist

Ing. Mark Suli

Drejtor

Rrok Ftuni

Përgjegjës

Ing. Zeqir Ujka



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
 PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Mb. 1826 Prot

Dt. 18.03.21

[Handwritten signature]

Nr. 226/1 Prot.

Shkodër, më 16 .03.2021

Lënda: Mbi Vendimin nr. 14, 15, 16 datë 26.02.2021 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS ✓

ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, neni 5, neni 56 KPAD, Urdhërit të Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2, gërma a, neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të VKM nr. 391, dt. 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, të shkresës së Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë nr. 339, datë 17.08.2020 “Kthim pergjigje”, të shkresës së Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë nr. 352, datë 21.08.2020 “Kthim pergjigje”, të shkresës së Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore nr. 1103/2 prot., datë 17.11.2020 “Përgjigje shkresës tuaj nr. 6551 prot., datë 09.11.2020”, shqyrtoi **VKB Vau Dejës nr. 14, 15, 16 datë 26.02.2021 rishqyrtim i Vendimit nr. 37, datë 25.06.2020, rishqyrtim i VKB nr.45/2020 dhe rishqyrtim i VKB nr.43/2020**”.

Pas shqyrtimit të këtyre vendimarrjeve të organit kolegjal, gjendemi përpara një situatë të njëjtë me argumenta të vjetër.

Ju sqarohet si vijon:

Kjo çështje lidhet me disa shkresa dhe korrespondenca për të cilat ju jeni dijeni të plotë; si shkresa e Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore Tiranë nr.1168/1 prot datë 23.10.2020, shkresa nr. 1103/2 prot., datë 17.11.2020, shkresa e ZABU Drin-Bunë nr. 339 prot, datë 17.08.2020 “Kthim pergjigje”, në të cilat qartëson/thekson për objektin e këtyre vendimeve se sipërfaqet e propozuara për tu dhënë me qera gjenden brenda shtratit dhe brigjeve të lumit Drin të cilat bien ndesh me

ligjin nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar.

Spektori përgjegjës për pyjet në Bashkinë Vau Dejës shprehet se sipërfaqja e propozuar për tu dhënë me qera është prapa argjaturës së lumit Drin dhe nuk përbën pengesë për dhënie në përdorim, tagër jo i Bashkisë Vau Dejës për një vlerësim të tillë, por Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, e cila është shprehur tashmë.

Siç ju është sqaruar referuar ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.2, gërma a, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, është në tagrin e këshillit bashkiak të japë në përdorim prona me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, një e drejtë kjo e padiskutueshme, por praktikat që janë në proces lidhen me basenin i cili trajtohet sipas një ligji të posaçëm dhe ka një regjim të ndryshëm juridik.

Nëse keni fakte apo argumenta të rinj, jeni të lutur t'i drejtoheni ZABU Drin-Bunë me qëllim trajtimin rast pas rasti për të qenë korrekt në zbatim të ligjit sipas shkresës së Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore Tiranë nr. 1103/2 prot., datë 17.11.2020.

Prefekti është i gatshëm për bashkëpunimin ndërinstitucional.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI

